



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.9.2023

Nr: 767

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 9.6.2021, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, "PËR CAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUESVE LIGJORË) DHE KUSHTET KONTRAKTUALE PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE GJATË VITIT KALENDARIK DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE KANDIDATËT E TYRE NË FUSHATËN ZGJEDHORE"**

Në mbështetje të neneve 19 pikat 1, shkronja "ë", e 2, 92/6 pika 3, dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 23/2 e 23/3, të ligjit nr. 8580 datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike", të ndryshuar,

VENDOS:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, bëhen këto ndryshime:
  - a. Neni 6, i kontratës së shërbimit për auditimin vjetor të partive politike, sipas shtojcës nr. 1, që referohet në pikën 8, të nenit 6, të udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 6

Detyrat e Ofruesit të Shërbimit

Ofruesi i shërbimit ka këto detyra:

- a) të kryejë shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë;
  - b) të kryejë shërbim pranë ambienteve të partisë politike që do të auditojë;
  - c) të verifikojë çdo informacion, dokument, llogari bankare apo të dhënë, që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e kryera nga partitë politike si dhe të marrë
- deklarata nga drejtuesit e partisë politike që auditon për

Data: 11.9.2023 Nr: 767  
Ora: 12:00



"Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore"

- çështjet që i nevojiten për të kryer shërbimin;
- d) të kryejë auditimin e partive politike nëpërmjet kontrollit të dokumenteve financiare e të llogarive kontabël të partive politike, të subjekteve të lidhura drejtpërdrejtë ose tërthorazi me partitë politike;
  - e) të depozitojë fizikisht dhe në format elektronik në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin e auditimit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës;
  - f) të hartojë raportin e auditimit me profesionalizëm, si dhe në përfundim të auditimit, audituesi ligjor i dorëzon partisë politike të audituar dhe KQZ-së projektraportin e auditimit, i cili përmban gjetjet dhe rekomandimet përkatëse sipas modelit KQZ-03-07, shtojca nr. 4, bashkëlidhur vendimit nr. 20, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe përcaktimin e mënyrës së pagesës së audituesve ligjorë”, në përputhje me ligji nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike” i ndryshuar, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar si dhe ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre;
  - g) nëse për arsye të përlegjura audituesi nuk dorëzon në KQZ projektraportin brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “e” të këtij neni, KQZ-ja mundet ta shtyjë afatin e dorëzimit të tij në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe për jo më shumë se 2 (dy) herë;
  - h) audituesi ligjor i dorëzon partisë politike dhe KQZ-së raportin përfundimtar të auditimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së shpjegimeve nga partia politike. Raporti përfundimtar hartohet sipas modelit KQZ-03-01, shtojca nr. 5, bashkëlidhur vendimit nr. 20, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe përcaktimin e mënyrës së pagesës së audituesve ligjorë”;
  - i) të verifikojë çdo informacion, dokument, llogari bankare apo të dhënë, që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e kryera nga subjektet politike dhe kandidatët e listave shumëmemërore;
  - j) të mos përfshijë të dhëna personale të dhuruesve nën vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
  - k) të paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kur i kërkohet, për sqarime të nevojshme, gjatë hartimit të raportit dhe pas depozitimit të raportit përfundimtar.”.



- b. Neni 6, i kontratës së shërbimit për auditimin e fushatës zgjedhore, sipas shtojcës nr. 2, që referohet në pikën 8, të nenit 6, të udhëzimit, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 6  
Detyrat e Ofruesit të Shërbimit

Ofruesi i shërbimit ka këto detyra:

- a) të kryejë shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë;
- b) të kryejë auditimin nëpërmjet kontrollit të dokumenteve financiare e të llogarive kontabël të subjekteve zgjedhore të audituara, të subjekteve të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me to;
- c) të kryejë shërbim pranë ambienteve të subjektit që do të auditojë;
- d) të hartojë raportin e auditimit me profesionalizëm, si dhe në përfundim të auditimit, audituesi ligjor i dorëzon subjektit zgjedhor të audituar dhe KQZ-së projektraportin e auditimit, i cili përmban gjetjet dhe rekomandimet përkatëse sipas modelit KQZ-03-13, shtojca nr. 6, bashkëlidhur vendimit nr. 15, datë 07.04.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, në përputhje me ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar si dhe ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre;
- e) nëse për arsye të përligjura audituesi ligjor nuk dorëzon në KQZ projektraportin brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, KQZ-ja mundet të shtyjë afatin e dorëzimit të tij deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe për jo më shumë se 3 (tre) herë;
- f) audituesi ligjor, pasi merr shpjegimet nga subjekti zgjedhor, i shqyrton ato dhe në rast se i vlerëson të arsyeshme, ndryshon ose plotëson pjesët përkatëse të raportit të auditimit duke i pasqyruar ato në raportin përfundimtar;
- g) audituesi ligjor i dorëzon subjektit zgjedhor dhe KQZ-së raportin përfundimtar të auditimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së shpjegimeve nga subjekti zgjedhor. Raporti përfundimtar hartohet sipas modelit KQZ-03-14, shtojca nr. 7, bashkëlidhur vendimit nr. 15, datë 07.04.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”;



- h) nëse raporti financiar i fushatës zgjedhore është paraqitur në KQZ nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar, audituesi ligjor bën vlerësimet dhe raportin po nëpërmjet kësaj platforme në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga KQZ-ja,
  - i) audituesi ligjor auditon raportin financiar të fushatës zgjedhore brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së tij prej KQZ-së. Auditimi kryhet në përputhje me rregullat dhe standardet e auditimit financiar të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
  - j) të mos përfshijë të dhëna personale të dhuruesve nën vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
  - k) të paraqitet në KQZ kur i kërkohet për sqarime të nevojshme, gjatë hartimit të raportit dhe pas depozitimit të raportit përfundimtar.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 11.9.2023 Nr: 767  
Ora: 12:00



“Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”